



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
DREJTORIA E HARTIMIT TË AKTEVE DHE SHËRBIMEVE JURIDIKE
SEKTORI I HARTIMIT TË AKTEVE DHE PËRPUTHSHMËRISË**

Nr. 2604 prot.

Tiranë, më 22.09.2025

URDHËR

Nr. 86, datë 22.09.2025

“PËR

DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN PËR ADMINISTRIMIN DHE PËRDORIMIN E SISTEMIT TË MENAXHIMIT TË ANKESAVE DHE DOKUMENTEVE TË PROCEDURËS HETIMORE (SMAD) PRANË ZYRËS SË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË, MIRATUAR ME URDHËR NR. 59 DATË 15.07.2022, TË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR ADMINISTRIMIN DHE PËRDORIMIN E SISTEMIT TË MENAXHIMIT TË ANKESAVE DHE DOKUMENTEVE TË PROCEDURËS HETIMORE (SMAD) PRANË ZYRËS SË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË”

Në mbështetje të nenit 204, pika 1, germa “c”, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, në mbështetje të nenit 137, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar

URDHËROJ:

1. Në kreun III, pika 15 të Rregullores për administrimin dhe përdorimin e sistemit të menaxhimit të ankesave dhe dokumenteve të procedurës hetimore (SMAD) pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, miratuar me urdhër nr. 59, datë 15.07.2022, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, bëhen ndryshimet e mëposhtme:
 - a. Shkronja “b”, nënpika “iv” ndryshohet sipas këtij formulimi:
“iv. shkeljen e pretenduar – ku verifikon plotësimin e rubrikave “Pretendime të ngritura”, dhe “Informacion shtesë”. Kur konstaton dallime apo vlerëson ndryshe nga sa është plotësuar nga ndihmësinsektori, bën plotësimet e

nevojshme për shkeljet e pretenduar në ankesë nga rastet e paracaktuara ose duke shënuar në rubrikën "Informacion shtesë".

b. Në shkronjën "c", pas nënpikës "v", shtohet nënpika "vi.", me këtë përmbajtje:

"vi. përzgjedhjen e një ose më shumë pretendimeve të ngritura në ankesë, nga lista e paracaktuar në rubrikën "Pretendime të ngritura".

c. pas shkronjës "c", shtohet shkronja "c/1", me këtë përmbajtje:

"c/1. Ndihmësinsektori- plotëson të gjitha rubrikat në SMAD, duke shënuar në kartelë çështje, pretendimet e ngritura në ankesë, tek rubrika e posaçme e emërtuar "Pretendime të ngritura", sipas rasteve të paracaktuara. Pretendime të tjera që nuk janë pjesë e rasteve të përcaktuara në rubrikë, shënohen në rubrikën "Informacion shtesë", ku reflektohet çdo shënim i nevojshëm kur pretendimet kanë të bëjnë me pretendime të tjera që nuk janë përfshirë në rubrikën "Pretendime të ngritura".

2. Ngarkohen me zbatimin e përcaktimeve të bëra në këtë urdhër, inspektorët dhe ndihmësinsektorët.

3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm me njoftimin dhe publikimin e këtij urdhri në faqen zyrtare të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Artur Metani

